




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

# Raport Shkollat promovuese të shëndetit nëpër vite



Prishtinë  
2013



**Raport**

**Shkollat promovuese**

**të shëndetit nëpër vite**

**Prishtinë**

**2013**

**Përgatiti:**

Leonora Shala

Bajram Kadriu

Miranda Kasneci

**Botues**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Rr. Agim Ramadani p.n

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

[www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net)

## **Rëndësia e edukimit dhe promovimit të shëndetësor në shkolla**

Sot në botë ekzistojnë shumë qasje që lidhen me faktin se çfarë në të vërtetë duhet të jetë shkolla, e cila do t'i plotësojë të gjitha kushtet ose shumicën prej tyre që të përmbushë elementet themelore të shkollave promovuese të shëndetit. Shëndeti, sot përkufizohet si një qasje e integruar në promovimin shëndetësor me qëllim të edukimit, informimit dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta për shëndetin dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha.

Ky koncept ka për qëllim të ndërrojë jo vetëm sjelljet e nxënësve, po edhe të personelit arsimor, të mjedisit në të cilin këta nxënës jetojnë, mësojnë dhe punojnë.

Shkollat që promovojnë shëndetin, inkurajojnë sjellje të shëndosha dhe njëkohësisht e bëjnë të njohur faktin që përgjegjësia për përmirësimin e shëndetit, nuk varet vetëm nga individi, por është një përgjegjësi me pjesëmarrje të përbashkët të të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë që promovon shëndetin.

Fëmijët duhet të angazhohen shumë në zgjedhjen e problemeve që kanë të bëjnë me shëndetin e tyre, si dhe të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek subjektet kompetente, në ndryshimin e veprimeve dhe aksioneve konkrete me qëllim të përmirësimit të shëndetit të tyre. Më herët është e njohur se fëmijët e shëndoshë mësojnë më mirë dhe se mësuesit e shëndoshë i mësojnë fëmijët me mirë. Promovimi dhe edukimi shëndetësor në shkolla është një nga elementet bazë të edukimit të nxënësve për të cilin shkollat duhet të investojnë sot dhe në të ardhmen. Prandaj të gjithë përfitojnë kur shkollat promovojnë shëndetin. Fëmijët gëzojnë përmirësimin e mirëqenies fizike, psikike dhe sociale. Ata mësojnë si ta ruajnë shëndetin gjatë kohës kur janë të ri dhe si ta aplikojnë njohuritë e reja në jetën e tyre të mëvonshme dhe t'i përcjellin të fëmijët e tyre (fëmijëri e shëndoshë – rini e shëndoshë).

Shkollat përfitojnë me kontributin dhe përkrahjen e prindërve dhe bashkësisë. Personeli i shkollës që përjeton ngritjen e aftësive mund të kryej punët me efektive dhe të përmirësojë shëndetin e tyre. Prindërit dhe pjesëtarët e komunitetit përfitojnë duke fituar njohuri më të gjëra mbi problemet shëndetësore dhe duke mësuar informata të reja mbi shëndetin si dhe duke marrë pjesë aktive në edukimin e fëmijëve të tyre. Ata sigurohen se shkolla e lagjes së tyre është e hapur për idetë dhe pjesëmarrjen e tyre.

Grupet e bashkësise dhe organizatat perfitojnë duke pasur pjesëmarrjen e nxënësve, arsimtareve në aktivitetet e bashkësisë. Njerezit e edukuar e të shëndoshë janë të nevojshëm për bashkesinë në tërësi.

Kombi me rini të shëndoshë dhe mirë të arsimuar, ka bazë për zhvillim të fortë ekonomik.

Bota, bënë progres në sigurimin e të drejtave njerëzore siç janë elaboruar me një numër të konventave ndërkombëtare shëndetësore dhe arsimore. Prandaj rëndësia e promovimit të shëndetit në shkolla është e madhe, pasi që shkolla mbulon një pjesë të madhe të popullatës duke e përfshirë këtu rininë. Afërsisht 1/5 e gjithë popullatës është në shkolla dhe fillet apo bazat mbi shëndetin vihen në këtë fazë të jetës.

Vlerat themelore të një iniciative të shkollave promovuese të shëndetit e cila bëhet edhe përmes partneritetit mund të jenë: respektimi i vetes, respektimi i ndryshimeve tek të tjerët, respekti për mjedisin, shfrytëzimi i tërësisë së ofertës që e bën shkolla si kurrikulave, familjes dhe bashkësisë me tërë spektrin e mundshëm të individëve, grupeve të interesit dhe institucioneve qeveritare dhe joqeveritare të ndërlidhura me konceptin e shkollave promovuese të shëndetit. Në mjedise të tilla është e mundur që mësimi të behët proces i vazhdueshëm dhe në vazhdimësi për tërë jetën.

Kjo do të mundëson që secili person të kontribuojë në familje dhe bashkësi përmes zbatimit dhe jetësimit në praktikë të shkathtësive të mësuara gjatë jetës. Prandaj mbrojtja dhe përparimi i shëndetit të fëmijës duhet të jetë synim parësor i shkollave dhe qeverisë së Kosovës. Shëndeti është pasuria më e madhe. Te gjithë së bashku duhet të kujdesemi dhe ta ruajmë atë.

Leonora Shala,

koordinatore për shkollat promovuese të shëndetit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



**Te gjithë kujdesemi për fëmijët, ata janë e ardhmja e Evropës.**

**“Çdo fëmijë dhe person i ri në Evropë, ka të drejtë, dhe duhet të ketë mundësi, që të edukohet në Shkollën për Promovimin e Shëndetit” (Rezoluta e konferencës ndërkombëtare te promovimit te shëndetit në Selanik, 1997).**

Shkollat Promovuese të Shëndetit ngrisin kapacitetet e të rinjve për të vepruar dhe sjellë ndryshime. Shkollat promovuese të shëndetit ofrojnë një mjedis, në të cilin të rinjtë fitojnë ndjenjën për arritjen e rezultateve, duke punuar me arsimtarët dhe të tjerët . Fuqizimi i të rinjve me vizionet dhe idetë e tyre mundëson që ata të kenë ndikim në jetën e tyre dhe kushtet e jetesës. Ky është definicioni i Organizatës Botërore të Shëndetësisë.” (OBSH,1997) Në kontekstin tonë, promovimi shëndetësor mund të prezantohet si kombinim i edukimit shëndetësor dhe aktiviteteve tjera që mund t’i ndërmarrë shkolla për të ruajtur dhe përmirësuar shëndetin e të gjithë atyre që gjinden në të.







## **SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT**

### **Historiku në Evropë**

Koncepti modern i shkollës promovuese të shëndetit ka origjinën nga simpoziumi i përbashkët i Organizatës Botërore të Shëndetësisë në vitin 1996 dhe grupi skocez për edukim shëndetësor i mbajtur në Skotlandë.

Nga viti 1993 deri më tani, 43 vende Evropiane janë anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Shkollave Promovuese të Shëndetit. Ky rrjet është themeluar në bashkëpunim të OBSH, (Zyra për Evropë, Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Përmes zbatimit të këtij programi edhe Kosova synon të jetë pjesë e këtij rrjeti dhe të përfitojë nga shkëmbimi i përvojave të vendeve të tjera anëtare të rrjetit.

Parimet që mbështesin shkollën promovuese të shëndetit janë dizajnuar në Konferencën e Selanikut në vitin 1997, ku u kërkua që të gjitha qeveritë e të gjitha shteteve të Evropës, të krijojnë kushtet që parimet si demokracia, barazia, autonomia dhe kompetenca e aksionit, ambientit shkollor, kurrikulës, trajnimi i arsimtareve, vlerësimi i suksesit, bashkëpunimi, (p.sh. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit,), bashkësitë (prindërit dhe komuniteti), qëndrueshmëria, të jetësohen në praktikë.

### **Historiku në Kosovë**

Ky program në Kosovë ka filluar me nismë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, UNICEF-it, IOM-it, ku me vonë në vitin 2004 me qëllim të jetësimit të këtij programi u lidh një Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të tri Ministrive, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Një partneritet i tillë ndërministror ndihmon në sigurimin se ekspertiza prej ministrive tjera është përdorur për programet, të cilat janë shumë sektoriale, siç është nisma e shkollave promovuese të shëndetit. Ministrinë relevante në vitin 2004 u pajtuan, të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) në mënyrë që:

- (1) të zhvillojnë politikat dhe të sigurojnë bashkëpunim ndërministror në fushën e edukimit shëndetësor dhe promovimit shëndetësor;
- (2) të promovojnë ambient të shëndoshë shkollor, ku nxënësit mund të përfitojnë njohuri dhe aftësi të reja; dhe
- (3) të përmirësojnë dhe forcojnë partneritetin ndërmjet shkollës, prindërve dhe komunitetit, dhe të gjitha agjencionet të kenë rol pozitiv në mirëqenien e tyre.

### **Komiteti ndërministror për shkollat promovuese të shëndetit**

Përmes kësaj marrëveshje u institucionalizua Komiteti ndërministror për shkollat promovuese të shëndetit, e më vonë nga Qeveria në shkurt të vitit 2005 punësohet si personel civil, koordinatori i cili i koordinon aktivitetet e Komitetit me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së programit.

Në përbërje të Komitetit janë përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë publike, një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë (sektori i planprogrameve dhe infrastrukturës), një përfaqësues nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përfaqësuesit e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, UNICEF-it dhe IOM-it dhe koordinatorja e programit.

Qëllimi i këtij programi është krijimi i një shkolle me plan-program të planifikuar për edukim shëndetësor si dhe ambienti, i cili mundëson zgjerimin e përvojave për të mësuar. Pra të krijohet një mjedis gjithëpërfshirës, i pranueshëm dhe miqësor që të arrihet arsimi cilësor në Kosovë. Shkolla promovuese e shëndetit është ajo shkollë, ku të gjithë anëtarët e saj dhe bashkësia punojnë bashkërisht që t'i ofrojnë nxënësve përvojë pozitive, me çka promovohet dhe mbrohet shëndeti i tyre. Kjo nënkupton përfshirjen e promovimit shëndetësor në kurrikula, krijimin e mjedisit të shëndoshë dhe të sigurt, ofrimin e shërbimeve shëndetësore adekuate dhe përfshirjen e familjes dhe bashkësisë së gjerë në aktivitetet promovuese të shëndetit. E gjithë kjo me qëllim të arritjes së një mënyrë të shëndoshë për tërë popullatën e shkollës në tërësi.

Programi Shkollat Promovuese të Shëndetit është pjesë e politikës shëndetësore dhe asaj të edukimit si dhe Planit strategjik të Kosovës.

Promovimi shëndetësor është pjesë e plan- programeve mësimore të Kosovës si çështje ndërprogramore dhe zgjedhore. Hartimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, ka përfshirë në masë të madhe konceptet e shkollave promovuese të shëndetit, njëra nga fushat kurrikulare është “Shëndeti dhe Mirëqenia” dhe është hartuar kurrikuli bërthamë për nivelin e arsimit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

Edukimi shëndetësor mund të trajtohet si lëndë e zgjedhur në të gjitha klasat. Shkolla vendos, sipas zgjedhjes së nxënësve, se cilat nga temat në kuadër të edukimit shëndetësor rekomandohen. Lënda me zgjedhje, prej momentit kur zgjidhet nga ana e nxënësve dhe miratohet nga organet përkatëse, ka status të njëjtë me lëndët e Kurrikulës bërthamë, d.m.th. është e detyrueshme për të gjithë nxënësit që e zgjedhin.

**Aktivitetet** **nëpër** **vite**  
Shumë aktivitete janë realizuar nga fillimi prej organizatave të ndryshme, të cilat pastaj janë koordinuar. Këto aktivitete i kanë paraprirë edhe zyrtarizmit të Komitetit të SHPSH dhe vizionit të përbashkët të SHPSH. Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 2003 me qëllim të mbështetjes së institucioneve vendore në realizimin e programit ka organizuar trajnime mbi konceptin, planifikimin edhe zhvillimin e shkollave promovuese të shëndetit. Pjesëmarrës të këtyre

trajnimeve ishin zyrtare të arsimit, shëndetësisë dhe mjedisit si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, drejtorë të shkollave dhe mësimdhënës. Ne këto trajnime janë përfshirë edhe pjesëmarrësit e të njëjtëve sektorë edhe te komunitetit serbë. OBSH po ashtu ka mbështetur edhe përkthimin e manualeve për trajnerë dhe mësimdhënës në lëmin e promovimit të shëndetit. Në këtë trajnim janë përfshirë 18 shkolla fillore në 3 komuna, në Mitrovicë, Prizren dhe Zveçan. Organizata Botërore e Shëndetësisë nga viti 2003-2005 ka trajnuar 90 mësimdhënës, 18 drejtorë shkollash, 20 profesionistë shëndetësorë dhe zyrtarë të mjedisit dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Këto trajnime janë bërë në konceptin e shkollave promovuese të shëndetit. Po ashtu, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve, OBSH ka organizuar vizita studimore në vende të tjera në Evropë, të cilat janë anëtare të rrjetit evropian të shkollave promovuese të shëndetit që nga viti 1993, si p.sh. në Slloveni, Poloni dhe Maqedoni.

Në prill të vitit 2006 OBSH për të mbështetur realizimin e suksesshëm të Programit Shkollat Promovuese të Shëndetit, ka angazhuar një konsulent të jashtëm për të vlerësuar programin dhe për të dhënë rekomandimet për hapat e mëtejshëm në hartimin e strategjisë së SHPSH.

Ne kuadër të vizitës së tij 5 ditëshe është organizuar edhe një takim rishqyrtues ku morën pjesë drejtorët dhe arsimtarët e të gjitha shkollave fillore të Mitrovicës, të cilët paraprakisht janë trajnuar në qasjen e shkollave promovuese të shëndetit, po ashtu nga konsulent të jashtëm të angazhuar nga OBSH. Organizata Botërore e Shëndetësisë pasi ka realizuar vlerësimin e rrezikshmërisë së mjedisit dhe shëndetit nga plumbi dhe metalet e rënda ka ndarë një shumë të caktuar të mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve mediale në shkollat e Mitrovicës, me qëllim të krijimit të një mjedisi të shëndoshë për punë, mësim dhe jetesë, duke e shfrytëzuar qasjen Shkollat Promovuese të Shëndetit .

Si rezultat i angazhimit permanent të OBSH , qoftë përmes përkrahjes së ofruar në nivel të Kosovës në promovimin e konceptit , ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve kosovarë, lobimit dhe prezantimit të të arriturave në Kosovë në këtë lëmi në strukturat relevante ndërkombëtare, është arritur që në nëntor të vitit 2007, Kosova të jetë anëtare e pranuar e Rrjetit Evropian të Shkollave Promovuese të Shëndetit.

Në këtë drejtim Kosova shquhet me faktin që për vite me radhë Organizatat qeveritare ndërkombëtare, institucionet dhe ministritë e përmendura më lartë, vazhdojnë të ndërtojnë në bazat e kësaj strukture pra të programit të Shkollave Promovuese të Shëndetit.

Edhe IOM, apo Organizata Ndërkombëtare për Migrim në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, në vitin 2003-2004 ka zbatuar projektin në shkollat fillore të Prizrenit, Mitrovicës dhe Gjilanit për edukim shëndetësor, ku janë trajnuar 70 pedagogë.

UNICEF-i ka iniciuar programin trajnues “Aftësitë për jetën” i cili është program i akredituar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe ofrohet si lëndë plotësuese për klasat e 8-ta. Është realizuar në 500 shkolla të mesme të ulëta të Kosovës dhe gjithashtu është bërë vlerësimi i programit.

Aktivitetet e tjera ka pasur edhe nga organizata joqeveritare PEN, (Rrjeti i edukatorëve bashkëmoshatar ) përmes të cilit, të rinjtë do të marrin informata tek bashkëmoshatarët e tyre për temat, si duhani, droga, dhe njëkohësisht krijimin e sjelljeve të shëndosha për shoqërinë në përgjithësi. Janë trajnuar 200 edukatorë nga të gjitha komunat e Kosovës.

Trajnimet e mësimdhënësve janë realizuar në vitet në vazhdim, ku në vitin 2010 në kuadër të programit ,: ” Shkollat promovuese të Shëndetit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në përkrahje edhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë e ka organizuar trajnimin e 60 mësimdhënësve të disa komunave të Kosovës në qasjen e shkollave promovuese të shëndetit. Në këtë trajnim përfaqësues të Rrjetit Evropian kanë këmbyer përvojat e tyre me Kosovën në kuadër të trajnimit tre ditor dhe vizitës me përfaqësues të ministrive relevante si dhe vizitës në dy shkolla fillore të kryeqytetit . Shkollat e vizituara kanë qenë shkolla;” Hasan Prishtina dhe ” Xhemajl Mustafa” në Prishtinë.

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që nga viti 2009 në kuadër të Projektit të Fondit Global , ka trajnuar 389 mësimdhënës për HIV/AIDS, afërsisht 100 mësimdhënës në çdo vit, për katër vite të projektit. Deri në vitin e pestë të projektit planifikohen të trajnohen edhe 100 mësimdhënës për të arritur numrin 500 sa është paraparë. Kriter kryesor ka qenë që mësimdhënësit të jenë të lëndëve, të cilat përmbajnë edukatë shëndetësore , kryesisht mësimdhënësit e biologjisë dhe edukatës qytetare. Në shkollat ku edukatën shëndetësore e kanë mbajtur mësimdhënësit e lëndëve tjera, janë pranuar edhe ata. Monitorimi dhe vlerësimi i trajnimeve është bërë nga ana e personelit me konkurs publik, një profesionist i doktoruar në fushën e AIDS.

Të gjithë mësimdhënësit e trajnuar janë pajisur me certifikata dhe të dhënat gjenden në bazën e të dhënave të projektit.

Aktivitetet e programit në nivel shkollë që i kanë paraprirë zbatimin të programit, kanë qenë themelimi i grupeve të shëndetit në shkolla me përfaqësues të mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, personelit të mirëmbajtjes së shkollës dhe atij administrativ, përzgjedhjes së koordinatorit për promovim të shëndetit në shkolla si dhe hartimit të planeve të zhvillimit në shkolla për përmirësimin e kushteve të jetës, punës, mësimdhënies e mësimnxënies. Në kuadër të programit SHPSH është mbajtur në Mitrovicë, takimi rishqyrtues si dhe vizita e konsulentit të Organizatës Botërore të Shëndetit, para të cilit kanë prezantuar aktivitetet të gjitha shkollat fillore të Mitrovicës, të cilat kanë qenë pjesëmarrëse të trajnimeve të organizuara më parë nga ekspertet e OBSH-së , zyra për Evropë.

Në vitin 2006 për nder të Ditës botërore të shëndetësisë me 7 Prill në Prizren është mbajtur për herë të parë takimi i edukatorëve dhe promotorëve shëndetësor, i organizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, në të cilin takim morën pjesë edhe përfaqësuesit e edukimit dhe promovimit të shëndetit nga Shqipëria.

Në këtë takim morën pjesë koordinatoresha e programit, përfaqësues, nga Komiteti ndërministror për shkollat e shëndetshme, përfaqësues të edukatorëve dhe promovuesve të shëndetit dhe shkollave promovuese nga Shqipëria, nga OJQ-të, OBSH, CARE, UNFPA, Kryqi i Kuq Zvicëran. Ky takim u mbajt në sallën e amfiteatrit në IKSHPK dega në Prizren. Në këtë takim gjithashtu u bë edhe hapja e ekspozitës të pllakatit shëndetësor dhe promovimit të Asociacionit të promovimit dhe edukimit shëndetësor të Kosovës.



*Foto nga takimi i parë i edukatorëve dhe promotorëve shëndetësor, 7 prill 2006*

Gjatë vitit 2008 janë realizuar dhe koordinuar aktivitetet me rastin e festave ndërkombëtare mjedisore nga Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me MASHT-in në kuadër të fushatave për vetëdijësim si: “Fushata me Moton në Kosovën e re me imazh të ri”, pastaj MASHT me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Ministrinë e Shëndetësisë, me rastin e datave ndërkombëtare si dita e luftës kundër duhanit, dita e luftës kundër tuberkulozit, etj.

Është realizuar studimi “Njohuritë, qëndrimet, përvojat dhe sjellja e të rinjve në Kosovë për HIV/AIDS, i mbështetur nga ekipi i përbashkët i Agjencive të Kombeve të Bashkuara për AIDS në Kosovë, bazuar në përgjigjet e dhëna, i cili ka nxjerrë në pah, se të rinjtë kosovarë të moshës 15-24 vjeç nuk kanë njohuri të mjaftueshme për HIV/AIDS.

Me qëllim të sensibilizimit të të rinjve dhe njoftimit për HIV/AIDS me 1 dhjetor 2008 në emër të bashkëpunimit ndërministror zyra për UNDC (Ekipi i përbashkët i OKB), ka shfaqur gatishmëri për të përkrahur MASHT-in, në zbatimin e një aktiviteti, një orë mësimi për HIV/AIDS.

Materialet , udhëzuesit , postarët dhe zarfet janë përkrahur nga fondet e zyrës për UNDC.





*Udhëzuesi i shpërndarë ne shkolla me rastin e 1 dhjetorit – Ditës ndërkombëtare kundër HIV/AIDS, 2008*

Gjithashtu janë shpërndarë edhe materiale edukative shëndetësore në shkolla për gripin A (H1N1) përmes drejtorive komunale të arsimit, të realizuara në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit publik dhe Organizatën Botërore të Shëndetit.

### Grip i derrave

**Këshilla për të sëmurët**

- Pini më shumë lëngje.
- Pushoni.
- Merrni ushqim cilësor me vitamina.

Ekziston terapia antivirale, e cila duhet të përdoret pas përshkrimit nga ana e mjekut. Terapia në fjalë është e suksesshme nëse merrni sa më shpejt pas paraqitjes së shenjave të sëmundjes.

Përpiluar nga Institutin Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës përkrahur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë zyra në Prishtinë, përmes fondeve të Qeverisë së Luksemburgut

Atë çka duhet të dini

**Personele të moduar u duhet:**

- të jetojnë në një ambient të agrotë familjar
- të realizojnë kontroll të rregullt mjekësor
- të jenë sa më aktiv fizikisht
- të shpërndihen sa më shumë me moduarit e vet
- të antarëtohen në organizata që merren me problemet e tyre
- të lexojnë sa më shumë libra
- të pushojnë dhe të bëjnë gjumë të rregullt
- të moduarve u duhet kajdes e respekt.

Mosha e vjetër është ajo që të cilën të gjatë e presim të na ndihet, me shëndet të mirë dhe me një jetë të lumtur, në gjumë e në të dashurave e paraqitjeve tona dhe në një ambient të dashur e të agrotë shoqëror.

Përpiluar nga Institutin Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, Komisioni i Edukimit Shëndetësor, Komiteti i Kosovës për Kërkime dhe Promovues të Shëndetit me përkrahje financiare të Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Prishtinë dhe fondeve të Qeverisë së Luksemburgut

**Pleqëria s' d  
të thotë vetr**



Në bashkëpunim me organizatën SOS me financim të Komisionit Evropian është miratuar nga MASHT-i është realizuar projekti: Festivali i fëmijëve "Lojë për të gjithë (Play for All)" me aktivitete shkollore me fëmijë të klasave 6-9/ku janë shpërblyer tri projektet më të mira për ambient të gjelbër. Objektivi i përgjithshëm i projektit ka qenë të ofrojë një hapësirë të sigurt për të gjithë fëmijët e Kosovës, të kenë qasje në aktivitete arsimore dhe rekreative me qëllim të nxitjes e zhvillimit të tyre dhe mirëqenies.

Në këtë projekt janë përfshirë niveli i lartë i shkollave fillore, prej klasës së 6 – 9. Aktivitetet e realizuara kanë qenë: gara për projektin mjedisor më të mirë, e cila është zhvilluar në grupe, d.m.th. nxënësit kanë punuar në grup dhe gjithashtu edhe shpërblimi i është ndarë grupit të punës.

### **Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit**

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës, qëndrimit në objektet shkollore, të mësimdhënies dhe të sigurisë, si dhe trajtimit të barabartë të gjithë pjesëmarrësve në procesin mësimor është shfaqur nevoja e hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse, të cilën e kemi emërtuar si Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit. Kjo strategji është edhe pjesë e Planit Strategjik të Arsimit Parauniversitar dhe ndërlidh sidomos pjesën e infrastrukturës, e cila kontribuon në krijimin e një shkolle dhe mjedisi shkollor bashkëkohor, sipas të gjitha parametrave dhe standardeve të pranuar ndërkombëtare.

### **VIZIONI**

**Një sistem efikas, brenda burimeve me të cilat disponohet, i cili siguron mjedis shkollor të hapur dhe nxitës për pjesëmarrje aktive, ku secili e ndien veten të sigurt, të barabartë e të lumtur, mjedis i cili do të jetë i gatshëm për adaptimin e standardeve të pranuar ndërkombëtare.**

### **MISIONI**

Me qëllim të realizimit të vizionit që kemi përcaktuar më përpara, është përcaktuar misioni i strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit, që është: **"Sigurimi i një mjedisi shkollor të shëndetshëm dhe miqësor përmes edukimit shëndetësor, promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe forcimit të partneritetit ndërmjet shkollës, prindërve dhe komunitetit.**

### **OBJEKTIVAT STRATEGJIKË**

- 1. Mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve**
- 2. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë**
- 3. Kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe materiale**
- 4. Përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve**
- 5. Shkallë e ulët e dhunës në shkollë**
- 6. Nivel i kënaqshëm i kulturës shëndetësore dhe mjedisore tek nxënësit**



*Foto nga grupet punuese gjatë hartimit të strategjisë për shkollat promovuese të shëndetit*

Ministria e Arsimit, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka hartuar dhe promovuar “Strategjinë për Sport” si dhe “Strategjinë për Shkollat Promovuese të Shëndetit 2009-2018



*Promovimi i strategjisë SHPSH, tetor 2009*



*Foto nga promovimi i strategjisë SHPSH, në foto prezentimi i menaxherit të Rrjetit Evropian, z. Goof BUJIS*





*Foto nga Dita e Tokës- 22 prill, sh.f ‘Dardania’ , Prishtinë 2009*

Në kuadër të fushatës për vetëdijësim me moton “Në Kosovën e re me imazh të ri” Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me MASHT, Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe disa organizata si: UNDP, Eptisa, LSD ka shënuar Ditën Botërore të Ujit-22 Marsin, Ditën Botërore të Tokës- 22 Prillin, dhe Ditën Botërore të Mjedisit - 5 Qershorit. Objektivi i këtyre aktiviteteve është sensibilizimi i komunitetit dhe institucioneve të Kosovës në brengat e mjedisit. Ministria e Arsimit, ka botuar materiale edukative (posterë), ndërsa në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, janë vlerësuar punimet e nxënësve në konkursin shpërblyes me rastin e 5 Qershorit- Ditës së Mjedisit.

Gjatë vitit 2009 si aktivitet i rëndësishëm që vlen të përmendet, është zbatimi i projektit në bashkëpunim me kompaninë apo shoqatën e ujësjellësve dhe kanalizimeve të Kosovës, SHUKOS. Programi “Miqte e ujit” është realizuar në 7 regjione të Kosovës me nga dy shkolla fillore, me qëllim të ruajtjes së ujit dhe përdorimit të tij sa më racional, si faktor i rëndësishëm për jetë. Objektivi i përgjithshëm i programit është rritja e ndërgjegjësimit tek fëmijët, për sa i përket çështjeve të lidhura me ujin, pikërisht në një moshë të re, nëpërmjet një metode mjaft interesante dhe interaktive duke kombinuar mësimet mbi principet bazë në lidhje me ujin, me lojëra dhe aktivitete, të cilat përforcojnë këto njohuri. Organizimi i këtij programi të edukimit për fëmijët bazohet në një marrëveshje zyrtare bashkëpunimi të nënshkruar midis Shoqatës së Ujësjellësve dhe Kanalizimeve” të Kosovës-SHUKOS, MMPH-se dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është bërë pikërisht në Ditën Botërore të Ujit, 22 mars 2009. Shkollat ku është zbatuar projekti “Miqte e Ujit 2009” ishin : “Ahmet Hoxha”, “Jeronim De

Rada” në Ferizaj, "Nonda Bulka" dhe "A.Z.Çajupi" Mitrovicë, "8 Marsi dhe "Ramiz Sadiku" në Pejë, " Abdyl Frashëri" " Lidhja e Prizrenit" në Prizren, "Yll Morina", "Mazllum Këpuska" në Gjakovë, " Ismail Qemajli" , " Gjergj Fishta" në Prishtinë, "Rexhep Elmazi", " Selami Hallaqi" në Gjilan.

Gjatë zbatimit të këtij projekti, përveç ligjëratave të organizuara në shkolla, është realizuar edhe gara e vizatimit dhe zgjedhja e 12 vizatimeve më të mira të fëmijëve për kalendarin mjedisor 2010 dhe fëmijët janë shpërblyer nga SHUKOSI me shpërblime simbolike.

MASHT në kuadër të programit dhe bashkëpunimit ndërministror ka përkrahur organizatën KHF (Kosovo Health Foundation), e cila në bashkëpunim me institutin Trimbos të Holandës, ka filluar zbatimin e pilot projektit për parandalimin e drogave të rinjtë (2010). Aktivitetet kanë qenë të fokusuar në dy komuna, në Prishtinë -4 shkolla , 2 filllore dhe dy të mesme dhe në Gjilan, po ashtu dy shkolla filllore dhe dy të mesme. Me këtë rast janë trajnuar 40 mësues në Prishtinë dhe 40 në Gjilan. Po ashtu janë përgatitur edhe materiale me informata për parandalimin e drogave

MASHT ka miratuar edhe projektin:” Droga është zero, jeta një” për realizimin e aktiviteteve në shkolla, me theks të veçantë parandalimin e drogave në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë në Bashkësi , OSBE dhe MSH-në.

Janë miratuar disa projekte nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për parandalimin e sëmundjeve transitive HIV/AIDS në bashkëpunim me OJQ-të Integra dhe OJQ Peen apo rrjeti i edukatorëve bashkëmohatar, të cilat kanë realizuar aktivitetet e parapara në disa shkolla të Kosovës.

### **Java e promovimit të shëndetit**

Sigurimi i një shkolle me të gjitha parametrat e kërkuara dhe në përputhje me standardet, është objektiv i MASHT, si në aspektin fizik dhe atë përmbajtësor. Në atë fizik, pos ndërtimit të shkollave të reja, anekseve, hapësirave për sport, synim është edhe sigurimi i ujit të pijshëm, nyjave, mirëmbajtjes së tyre dhe krijimi i mjedisit të shëndetshëm dhe të sigurt për nxënësit në të gjitha shkollat.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me Komitetin ndërministror në shkurt të vitit 2009 , ka marrë nismën për javën e promovimit të shëndetit me qëllim të zbatimit të Strategjisë nderministrorë dhe aktiviteteve të saj.

Aktiviteti është realizuar në komunat të ndryshme të Kosovës (Suharekë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë), gjatë muajit shkurt dhe gjatë kësaj jave është promovuar formimi i komiteteve rajonale me qëllim të realizimit të programit dhe ruajtjes së shëndetit të fëmijëve.



*Foto nga punimet e nxënësve gjatë ekspozimit të ekspozitës në Ferizaj, gjatë javës së promovimit 2009*



*Takimi ne Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gjilan*



*Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Ferizaj*

Në qershor të vitit 2009, dy përfaqësues të Kosovës (koordinitorja e programit dhe kryetarja e Komitetit ndërministror) kanë qenë pjesëmarrës në Konferencën e tretë ndërkombëtare të edukimit dhe promovimit të shëndetit në Vilnius të Lituanisë me temë "Better schools through health" (shkolla më të mira të shëndetshme).

Në tetor të po këtij viti po ashtu dy përfaqësues të MASHT, koordinitorja dhe zyrtarja e trajnimeve si dhe një mësimdhënëse nga Prizreni kanë marrë pjesë në punëtorinë e koordinatoreve nacional për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore,



në forcimin e planit nacional strategjik për programin SHPSH, që është mbajtur në Mavrovë të Maqedonisë . Është organizuar edhe vizita në dy shkolla fillore të kryeqytetit, me rastin e ardhjes së përfaqësuesve të rrjetit evropian në Kosovë. Në këtë punëtori Kosova, ka prezantuar të arriturat dhe shumë i rëndësishëm ishte edhe këmbimi i përvojave me shtetet e tjera të Evropës, pjesëmarrëse në punëtori si Maqedonia, Kirgistani, Rusia, Moldavia, Kazakistani, Gjorgjia, etj.



*Foto nga punëtorja e mbajtur në Mavrovë të Maqedonisë me koordinatore të Rrjetit SHE, Paraqitja nga Kosova, koordinatore e programit SHPSH*



*Foto nga punëtorja e koordinatoreve nacional- Schools for Health in Europe, Mavrovë 2009*



*Prezentimi i shteteve pjesëmarrëse në punëtorinë SHE, Mavrovë.*



*Pamje nga vizita në shkollën "Xhemajl Mustafa" Prishtinë, 2009*

Në muajin prill 2010 është organizuar java e gjelbërimit të shkollave, MASHT bashkë me Ministrinë e Bujqësisë kanë shpërndarë 10 000 fidane në shkollat e Kosovës, për ta gjelbëruar mjedisin përreth tyre. Aksioni është realizuar me sukses dhe synohet që edhe në vitet tjera të vazhdohet me nisma të tilla.

Ministria e Mjedisit ka realizuar aktivitete të shumta, të cilat janë koordinuar bashkë përfshirë edhe përfaqësuesen nga Ministria Arsimit konkretisht nga programi i shkollave të shëndetshme, ka mbajtur manifestimin qendror për shënimin e 22 Prillit- Ditës Botërore të Tokës, që është mbajtur në kazermën FSK "Adem Jashari" Prishtinë, ku po ashtu është bërë mbëltimi i fidanëve në hapësirën para shtabit qendror.





*Foto në kazermën FSK "Adem Jashari" Prishtinë*

Ndërsa në fshatin Koshtovë-Mitrovicë është bërë pyllëzimi i hapësirës prej 2 hektarësh nga përfaqësues të FSK dhe nxënës të shkollave të mesme të Mitrovicës.



*Foto në fshatin Koshtovë-Mitrovicë*



Kete dite aktivitetet janë shënuar edhe në sheshin “Nëna Terezë” Prishtinë në bashkëpunim me USAID Basic Education Program dhe nxënës të shkollave fillore me **moton “Redukto, Ripërdor dhe Riciklo”**. Edhe ne Parkun “Gërmia” në Prishtinë –është realizuar programi me nxënës të shkollave fillore nga Komuna e Prishtinës për mbëltimin e fidanëve dhe luleve të ndryshme.



*Aktivitete me rastin e dites Boterore te Tokës ne Sheshin Nënë Tereza -Prishtinë*



Për të ngritur kapacitetet njerëzore MASHT në bashkëpunim me OBSH-në dhe Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës është mbajtur trajnimi i 60 mësimdhënësve të shkollave të disa komunave të Kosovës për qasjen e shkollave promovuese të shëndetit, ligjërues kanë qenë ekspertët e rrjetit Evropian të SHPSH. Komunat që janë përfshirë në trajnim 2010 në qasjen e shkollave Promovuese të Shëndetit Maj 24-26 2010 janë : Prishtina, F.Kosova, Drenasi, Podujeva, Obiliqi, Ferizaji, Lipjani, Kaçaniku, Gjakova, Malisheva, Gjilani, Mitrovica, Prizreni, Skenderaj, Vushtrri, Peja, Istogu, Suhareka.





*Foto me mesimdhënesit e trjnuar*



*Foto gjate trajnimit*



*Përfaqësues të rrjetit evropian kanë vizituar dy shkolla fillore ne kryeqytet "Hasan Prishtina" dhe "Xhemajl Mustafa".*



Trajnime në fushën “Marrëdhënie me publikun dhe informim publik”

Basic Education Program i USAID-it (BEP) së bashku me partnerin zbatues KEC-in, organizoi një punëtori trajnimi dhe certifikimi për kryefasilitatorët dhe fasilitatorët e shkollave. Përveç marrjes së certifikatave, fasilitatorët morën pjesë në disa seanca trajnimi me qëllim të mprehjes së shkathtësive të tyre dhe shkëmbimit të përvojave dhe sfidave me kolegët. Përfaqësues nga MASHT, USAID, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor, BEP dhe KEC u shpërndanë certifikatat 18 kryefasilitatorëve dhe 95 fasilitatorëve gjithsej: 14 fasilitatorë të gjuhës angleze, 18 fasilitatorë të lëndëve lidhur me mjedisin, 22 fasilitatorë të teknologjisë, 19 fasilitatorë të shkencave; dhe 22 fasilitatorë të fushës së vlerësimit.

Gjate vitit 2010 është bërë fillimi i implementimit të Paketës së Gjelbër (Trajnimi i mësimdhënësve) e cila është përgatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Juglindore, dhe është implementuar nga Zyra e kësaj qendre në Kosovë, në bashkëpunim me MASHT-in dhe MMPH-në. Gjatë kësaj periudhe është bërë shpërndarja e Pakos së Gjelbër në të gjitha shkollat e Kosovës nga një ekzemplar. Pra janë shpërndarë 1100 pako, prej të cilave 950 në gjuhën shqipe dhe 150 në gjuhët e komuniteteve. Është bërë rekrutimi dhe licencimi i 12 trajnerëve të cilët më pas kanë bërë trajnimin e më se 1000 mësuesve, kryesisht nga lënda e biologjisë, kimisë, edukatë qytetare etj. Trajnimi i mësimdhënësve ka vazhduar edhe në vitin 2012.

MASHT në bashkëpunim edhe me ministritë tjera, po bëjnë përpjekje që të zbatohen programe për sigurinë, për zvogëlimin e dhunës në shkolla, në krijimin e klimës së bashkëpunimit në mes të nxënësve, për hartimin e strategjisë për shëndetin e nënës dhe fëmijës si dhe të adoleshentëve.

MMPH në bashkëpunim me MASHT për çdo vit kanë shënuar festat mjedisore si 22 Marsin Diten e Ujit, 22 Prillin - Ditën e Tokës, këtë ditë ku janë mbëltuar fidane dhe lule dekorative pranë objektit të MASHT dhe MMPH.



*Foto gjate mbeltimit te fidneve nga dy ministrat e MASHT dhe MMPH*



Si vazhdimësi e aktiviteteve MASHT-i që disa vite ka filluar me javën e promovimit të shëndetit, ku këtë vit është shënuar si java e pastërtisë. Njëherit është iniciuar edhe gara për zgjedhjen e 3 shkollave më të pastra në nivel shtetëror. Kjo javë është bashkërenduar edhe me aktivitetet e drejtorive komunale të arsimit, ku të gjitha shkollat përveç pastrimit të ambienteve shkollore, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare kanë realizuar edhe aktivitete mjedisore si; riciklimi i mbeturinave, mbajtja e ligjëratave për mjedisin, etj. Ka vazhduar koordinimi i aktiviteteve edhe me Sektorin për edukim dhe ndërgjegjësim të MMPH në saxe të bashkëpunimi ndërministror ku edhe këtë vit janë realizuar ligjërata për mjedisin me temën riciklimi i mbeturinave në shkolla në shumicën e komunave. Për ta ruajtur në vazhdimësi ambientin ku jetojmë, punojmë e mësojmë Ministri i Arsimit ka nxjerr vendim për realizimin e projektit: Mjedis i gjelbër dhe i pastër në shkolla për vitin shkollor 2011-2012, aktivitet ky që është mbështet edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Për vazhdimësinë e qasjes së shkollave promovuese të shëndetit dhe me kërkesë të mësimdhënësve Organizata Botërore e Shëndetësisë do të përkthejë materialet e rrjetit evropian për ushqyeshmërinë e shëndoshë. Për ta ruajtur shëndetin publik dhe përparuar shëndetin e fëmijëve në shkolla, MASHT në kuadër të Departamentit të Inspektimit në bashkëpunim me zyrën për promovim të shëndetit si dhe inspektoriatin sanitarë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë kanë vizituar disa shkolla në kryeqytet për të ndjekur zbatimin e ligjit për duhanin dhe vendosjen e shenjave ndaluese në shkolla. Në mbrojtje të shëndetit të popullatës në veçanti fëmijëve në shkolla, nga pasojat shkatërruese të duhanit për shëndetin, shoqërinë, ambientin dhe ekonominë, nëpërmjet të zbatimit dhe përmirësimit të kornizës Ligjore, me iniciativë të Institutit Kombëtar të Shëndetit e Publik, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis partnereve shumë sektorial për formimin e koalicionit anti-duhan në Kosovë, pjesë e të cilit ishte edhe Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, e OJQ KADC e OBSH, UNICEF. Konstatim i përbashkët i këtij koalicioni ishte avokimi për ndryshimin e ligjit aktual për duhanin dhe miratimin e një ligji të ri që krijon mundësi për një ambient krejtësisht të lirë pa duhan.

MASHT-i në bashkëpunim edhe me Ministrinë tjera, si Ministria e Punëve të Brendshme, konkretisht policinë e komunitetit ka realizuar aktivitete parandaluese për të ngritur vetëdijesimin e të rinjve për sigurinë në rrugë ku bashkërisht kanë promovuar manualin për sigurinë e fëmijëve në trafik si dhe kanë realizuar ligjërata për drogën me nxënës në shkolla. Me qëllim të zbatimit të politikave të hartuara nga programi multisektorial siç është Shkolla promovuese e shëndetit, MASHT këtë vit, bashkë me UNICEF dhe me Kec-in kanë vazhduar implementimin e projektit krijimi i mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme në shkolla. Në kuadër të projektit, financuar nga UNICEF dhe

implementuar nga KEC, është zhvilluar një hulumtim në shkollat ku është intervenuar. Nga 254 shkolla që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, në 148 apo 58.27% të shkollave janë formuar Këndet për të drejtat e fëmijës. Aty prezantohen punime të ndryshme artistike, vepra arti që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes së nxënësve për të drejtat e tyre, si dhe për problemin e dhunës, pa marrë parasysh llojin e saj.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar shumë takime të Komiteteve komunale dhe atyre Rajonale që janë pjesë e Rrjetit mbrojtës. Në takimet e zhvilluar kanë qenë të përfaqësuar të gjitha palët (përfshirë: drejtorët e shkollave, mësimsdhënësit, prindërit, nxënësit, policia, Qendra për punë sociale, DKA etj.) me qëllim të diskutimit të problemit të dhunës në shkolla dhe ofrimit të zgjidhjeve alternative për problemet e identifikuara. Si rezultat i punës dhe zbatimit të projektit është hartuar edhe dokumenti “Protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar”. Ekzistojnë format e raportimit dhe referimit të rasteve të paraqitjes së dhunës. Në të ardhmen do të hartohet udhëzuesi për përdorimin e këtyre formave dhe databazës në përgjithësi.

Në takimet e Komiteteve Rajonale dhe Komunale kanë qenë të përfaqësuar thuajse të gjitha këto institucione (drejtorët e shkollave, mësimsdhënësit, prindërit, nxënësit, policia, Qendra për punë sociale, DKA etj.)

Kanë vazhduar aktivitete me të rinjtë në të gjitha rajonet në kuadër të Rrjetit të edukatoreve bashkëmoshatarë me realizimin e tryezave të rrumbullakëta në të gjitha rajonet. Rrjeti i edukatoreve bashkëmoshatarë është iniciativë e të rinjve e që ka për qëllim promovimin e konceptit të edukimit bashkëmoshatarë si qasje e informimit dhe edukimit të rinjve në parandalimin e HIV/AIDS-it, promovimit të aftësive për jetë dhe edukimit shëndetësor, mbrojtjes së ambientit, etj. Në Kornizën e Kurrikulës së re të Kosovës, sfera e shëndetit është vendosur fushë më vete për t’u trajtuar si tema të veçanta gjatë gjithë shkollimit për nxënësit, për të krijuar njohjet dhe shkathtësitë e duhura për shëndetin individual dhe të përgjithshëm në kohët e sfidave të reja.



*Foto nga përfaqësuesit e punëtorisë të mbajtur në Strugë dhe nisma e projektit: "Krijimi i mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme në shkolla".*

Gjatë vitit 2012 ka vazhduar punën në zbatimin e dokumenteve strategjike për krijimin e mjedisit të shëndoshë e të sigurt në shkolla, me qëllim të ngritjes së vetëdijes në këtë drejtim të gjithë faktorëve relevant në shkollë, por edhe më gjerë. Për këtë ka vazhduar bashkëpunimi ndërministror, po ashtu edhe në nivel komunal për të krijuar mekanizma për të siguruar mjedis të favorshëm për punë të suksesshme të nxënësve, mësimit dhe të tjerëve.

Kështu janë hartuar Standardet për Shkolla Mike për Fëmijë nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me MASHT dhe UNICEF-in dhe pasi është bërë diskutimi publik me akterët të ndryshëm, këto standarde janë finalizuar. Standardet mund të gjinden të postuara ne faqen zyrtare të MASHT. Standardet kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit në Kosovë, në përkrahje të krijimit të shkollave efektive, të shëndetshme, mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse.

Po këtë vit koordinatorja e programit SHPSH bashkë me anëtarë të tjerë të Komitetit ndërministror, ka vizituar disa shkolla në 17 komuna të ndryshme të Kosovës për të bërë vlerësimin e shkollës me mjedis më të pastër dhe të gjelbëruar, për nder të Ditës së Mjedisit. Me 5 Qershor është shënuar Dita e Mjedisit, ku MASHT në bashkëpunim edhe me MPH M si dhe DKA-të kanë shpërblyer tri shkolla me mjedisin më të pastër dhe të gjelbëruar. Me vendin e parë është shpërblyer SHFMU : "Liria, Milloshevë, vendi i dytë:" Martin Camaj"- Gurakoc, dhe vendi i tretë : shkolla" Kajtaz Ramadani " Kijevë.



*Shkolla "Liria" Milloshevë – vendi i parë*





*Shkolla "Martin Camaj- vendi i dytë*



*Shkolla "Kajtaz Ramadani- Kijevë, vendi i tretë*

Ministria e Mjedisit gjegjësisht Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit gjatë viteve 2009-2013 ka realizuar objektivat në bazë të prioriteteve të parapara me plan dhe program për vitet e lartcekura si dhe me obligimet që dalin nga korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit si dhe Strategjia për Shkollat Promovuese të shëndetit në Kosovë 2009-2018 gjegjësisht Plani i Veprimit për periudhën 2009-2013. Gjatë këtyre viteve janë realizuar një mori Ligjërata në shkolla të mesme të ulëta për problemet mjedisore si në Rajonin e Mitrovicës, Gjilanit , Pejes, Gjakoves, Prishtines. Janë përfshirë gjithsejt 55 shkolla fillore me 3630 nxënës të niveleve prej Kl.V deri klasën e IX dhe një nr i konsiderueshëm i personeli arsimor. Gjatë kësaj periudhe kohore nëpër shkolla për nxënës janë shpërndarë materiale të ndryshme për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor si: Broshura "Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Mjedisor " Revista "Mjedisi", Fletëpalosje, Postera të ndryshëm si dhe Raporte të ndryshme mjedisore etj.



Ne kuadër të bashkëpunimit në mes të MASHT dhe UNICEF, si dhe bazuar në vendimin e Qeverisë për të hartuar plane sektoriale të veprimit për emergjencë, si pjesë e planit kombëtar për reagim në emergjencë (Ligji, Agjencioni etj.), përfaqësuesit e zgjedhur nga MASHT kanë përfituar nga trajnimi i organizuar nga UNICEF- Zyra regjionale për Evropën Juglindore, për emergjencat në arsim dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, të mbajtur në muajin maj 2011, në Mal të Zi.

Si vazhdimësi e kësaj nisme, është përpiluar një plan pune nga ekipi i Kosovës për të shqyrtuar mundësinë e hartimit të politikave në koordinim me zyrën Regjionale të UNICEF-it në Gjenevë dhe është siguruar asistencë teknike nga kjo e fundit për ndërtimin e kapaciteteve për emergjencë në arsim, si në nivel regjional ashtu edhe në nivel vendi. Asistenca teknike është ofruar nga këshilltarja e angazhuar nga UNICEF, zinj. Cynthia Koons në Kosovë dhe zyra e UNICEF-it në Kosovë.

Në këtë drejtim MASHT ka hartuar udhëzimin administrativ për shmangien e situatave të jashtëzakonshme.

Në tetor të vitit 2012 koordinatorja e programit dhe një përfaqësues nga plan-programet kanë prezantuar në takim me përfaqësues të Rrjetit Evropian dhe Shqipërisë në Tiranë, ku janë shkëmbyer edhe përvoja me mësimdhënësit e shkollave pilot të Tiranës në qasjen e shkollave promovuese të shëndetit.





*Pamje nga takimi në Tiranë, nëntor 2012 (menagjeri i rrjetit evropiane për SHPSH Gof BUJIS, koordinatori nacional i Shqipërisë z. Engjell Mihali , koordinatoja e programit në Kosovë znj Leonora Shala, si dhe drejtorë shkollash e mësimdhënës nga Tirana*

Është realizuar hulumtimi, dhe është bërë prezantimi i të dhënave të pilot-projektit “Shëndeti i Fëmijëve në Kosovë” i përgatitur prej Universitetit të Mjekësisë në Hamburg dhe OJQ-së “Fëmijët e së ardhmes”-Kosovë.

Edhe në vitin 2013 ka vazhduar gara në përzgjedhjen e tri shkollave me mjedis të gjelbër dhe të pastër dhe janë shpërblyer, po ashtu tri shkolla: ” Rasim Kiqina”-Drenas, ka marrë vendin e parë, ” Avdullah Shabani-Mitrovicë, vendi i dytë dhe “4 Dëshmorët” - Ratkoc, vendi i tretë.



*Shkolla fillore e mesme e ulët Rasim Kiqina-Drenas, vendi i parë*





*Shkolla "Avdullah Shabani"-Mitrovicë, vendi i dytë*



*Shkolla "4 dëshmorët"-Ratkoc, vendi i tretë*

OJQ –KICKOMS – në bashkëpunim me KNSHPSH ka filluar realizimin e aktiviteteve promovuese për shëndetin oral, me moton: "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur". Java e promovimit të shëndetit ka filluar në shkollën "Hasan Prishtina", në Prishtinë, ku edhe është mbajtur manifestimi qendror me pjesëmarrjen edhe të ministrit të shëndetësisë.

Ligjëratat për mirëmbajtjen e dhëmbëve dhe parandalimin e sëmundjeve të gojës, janë mbajtur edhe në shkollat si: "8 Marsi"- Pejë, "Thimi Mitko"-Gjilan, "Lidhja e Prizrenit"- Prizren, "Yll Morina"-Gjakovë, "Jeronim De Rada"- Ferizaj, dhe "Migjeni"-Mitrovicë.

Në 7 komunat e shpërblyera dhe të vizituara gjatë javës është shpërndarë edhe materiali udhëzues për zgjerimin e edukimit shëndetësor në shkolla: "I shëndoshë dhe i lumtur" i ribotuar nga MASHT.



*Foto nga java e promovimit te shëndetit "8 marsi"- Pejë, 2013*



Faza e dytë e zbatimit të projektit “Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur” përmes të cilit janë përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbi 1150 institucione parashkollore, fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës, përkatësisht janë përfshirë rreth 450 mijë fëmijë-nxënës.

Deri tani janë vizituar afër 2/3 e institucioneve parashkollore në Kosovë. Gjatë këtyre vizitave fëmijëve u janë dhënë broshura si dhe brusha të dhëmbëve me pastë. Gjithashtu u është bërë demonstrimi i pastrimit të dhëmbëve përmes modeleve, gjë të cilën e kanë bërë edhe fëmijët. Konkretisht, në numër janë vizituar mbi 50 Institucione parashkollore publike dhe private në Kosovë.

Gjithashtu janë përfshirë mbi 150 institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të komunave Pr si Prishtinë, Podujevë, FushëKosovë, Obiliq, Drenas dhe Lipjan. Gjatë vizitave, me nxënësit e klasës së I-rë, II-të, III-të, IV-të, V-të, VI-të, VII-të, VIII-të dhe IX-të, është bashkëbiseduar për ushqimet e preferueshme dhe jo të preferueshme për dhëmbët, është bërë demonstrimi i përbashkët i pastrimit të rregullt dhe të drejtë të dhëmbëve përmes modeleve, u janë dhënë brusha të dhëmbëve nxënësve si dhe materiale promovuese për shëndetin oral, për ushqimet, pastrimin e dhëmbëve dhe fluoridet.

Me 12 shtator 2013 është shënuar edhe dita ndërkombëtare e shëndetit oral, ku KNSHPSH bashkë me OJQ KISCKOMS kanë realizuar edhe një tryeze të rumbullaket, ku si rekomandim ka dalë që së që në institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës, të promovohet të ushqyerit e shëndetshëm duke evituar konsumimin e pijeve të gazuara dhe ushqimeve shumë të kriposura dhe të sheqerosura që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e fëmijëve.



*12 shtatori –dita botërore e shëndetit oral- kopshti-Dielli, 2013*





*Foto nga Tryeza e rrumbullakët 12 shtatori –dita botërore e shëndetit oral, 2013*

Policia e komunitetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, bazuar edhe në programin shkollat promovuese të shëndetit) ka mbajtur debate me mësimdhënës, drejtorë shkollash, nxënës dhe prindër për pasojat që sjell përdorimi i substancave narkotike në 6 komuna: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Dragash, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Për promovimin dhe ruajtjen e shëndetit mendor OJQ “Together Kosova” ka marrë përkrahjen nga MASHT për të realizuar një projekt nëpër shkolla.

Gjatë një projekti të realizuar nga Fondacioni “Together Kosova” i cili kishte të bënte me parandalimin e vetëvrasjeve nëpër shkolla, u vërejt një mungesë e madhe e shërbimeve psikologjike në shkolla dhe me qëllim të tejkalimit të mungesës së shërbimeve këshilluese të mirëfillta për të rinjtë, Fondacioni Together Kosova, ka dizajnuar një projekt për këshillimin online të rinjve dhe ka marrë si model web faqen në Slloveni, e cila ofron ndihmë të shpejtë dhe profesionale në formë anonime dhe pa pagesë.

Web faqja [www.nukjevet.net](http://www.nukjevet.net) prej fillimit të saj ka ofruara 6008 përgjigje profesionale të ekspertëve, ka pranuar 6238 pyetje nga përdoruesit, ka pas 314,550 vizitorë, 194,794 vizitorë unik, 5801 komente nga shfrytëzuesit e ueb faqes si dhe 787 persona e kanë plotësuar pyetësorin për orientim në karrierë.



Një ndër karakteristikat më me rëndësi të kësaj ueb faqeje janë ofrimi i ndihmës dhe këshillimit profesional, plotësisht anonim dhe të sigurt i të rinjve. Ata në këtë ueb faqe mund të pyesin dhe shpalosin me ekspertët e angazhuar brengat e tyre më intime dhe kërkojnë këshilla për situatat e tyre jetësore. Vlerë shtesë e kësaj ueb faqe paraqesin ekspertët e grupit këshillues, të cilët e japin kontributin e tyre në mënyrë vullnetare. Për momentin kemi nja numër prej 33 ekspertëve nga fusha të ndryshme si urologë, dermatologë, gjinekologë, psikiatër, internistë, nutricionistë etj), sociologë, seksologë, estet mjekësor, psikologë (shkollor, klinik ejt) etj.

Të rinjtë të cilët përfshihen në këtë ueb faqe kanë mundësi të shumta, përveç këshillimit online ata mund të lexojnë artikuj të ndryshëm shkencorë në lidhje me temat, të cilat i preokupojnë ata më shumë, pastaj në këtë ueb faqe ata mund të gjejnë pyetësorin për orientim në karrierë i, cili është një test i standardizuar që u dedikohet maturantëve, pas plotësimit të këtij pyetësori ata e marrin një përgjigje me këshilla në bazë të atyre përgjigjeve që ata i kanë jap, se për cilën fushë janë më të përgatitur.

Mundësi tjetër e re dhe për herë të parë në Kosovë, është edhe mundësia e këshillimit online nëpërmjet chat-it. Ky lloj shërbimi është ende në fazën e testimit dhe ofrohet në orarë të caktuar gjatë javës, por deri më tani ka rezultuar mjaft i suksesshëm dhe shumë i nevojshëm për të rinjtë.

Disa nga ekspertët e kësaj fushe kanë mbajtur ligjërata nëpër shkolla, ku është shpjeguar se si këta të rinj të kenë më të lehtë t'i qasen marrjes së këshillave online nga ekspertë përkatës të fushave të ndryshme si dhe ligjërata të përgjithshme mbi shëndetin mendor dhe rëndësinë e tij.

Gjatë vitit 2013 deri më tani janë mbajtur ligjërata në Rajonin e Prishtinës, Junikut, Mitrovicës dhe Deçanit. Janë përfshirë gjithsej 7 shkolla fillore me mbi 442 nxënës të niveleve prej kl.V deri klasën e IX dhe një nr. i konsiderueshëm i personeli arsimor. Gjatë kësaj periudhe kohore nëpër shkolla për nxënës janë shpërndarë materiale të ndryshme për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor si: broshura “Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Mjedisor” revista “Mjedisi”, fletëpalosje, raporte të ndryshme mjedisore, postera të ndryshëm etj

## **Infrastruktura**

Me projektin e Bankës Botërore janë mbledhur te dhënat për gjendjen fizike te gjitha objekteve shkollore ne Kosove. Janë hartuar normat dhe standardet për ndërtesat shkollore. Ka vazhduar ndërtimi i objekteve te reja shkollore dhe renovimi i hapësirave ekzistuese, ku nga viti 2008 MASHT ka ndërtuar 85 objekte dhe ka rinovuar 15 objekte. Njëherit, MASHT ka pajisur me inventarin e nevojshme shkollor te gjitha shkollat e reja. Sa i parkete mirëmbajtjes Divizioni

i Infrastrukturës ka përgatitur një draft, i cili me tepër i takon afatit dhe qëndrueshmërisë të materialeve ndërtimore.

Njëra nga sfidat me të cilën ballafaqohen shkollat është arritja e ekuilibrit në mes të edukimit që ka të bëjë me temat shëndetësore dhe besimi në promovimin e shëndetit të fëmijëve përmes promovimit shëndetësor..

## **Përfundim**

Mbrojtja dhe përparimi i shëndetit të fëmijës duhet të jetë synim parësor i Qeverisë së Kosovës në veçanti MSH-së.

Mbështetur në Konventën për të drejtat e fëmijës ç' do shtet pjesëmarrës duhet të marrë masa dhe të garantojë çdo fëmije të drejtën e jetës duke përfshirë këtu edhe përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të fëmijëve dhe cilësisë së jetës së tyre.

Të gjithë nga pak mund të bëjmë shumë për shëndetin e fëmijëve tanë!











